

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 24.09.2016

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	10	
4. Problemi 4	30	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

- a) Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 tregoi një fitim neto prej € 83,600. Më pas u gjet se € 18,000 të paguara për blerjen e një furgoni ishin debituar në llogarinë e shpenzimeve të automjeteve. Politika e kompanisë për zhvlerësimin e automjeteve motorike është 25% në vit me metodën drejtvizore, me ngarkimin e plotë në vitin e blerjes.

Kërkohet: Cili do të jetë fitimi neto pas korrigjimit për këtë gabim? (5 pikë)

Fitimi	83,600
Blerja e furgonit	18,000
Zhvlerësimi $18,000 \times 25\%$	<u>(4,500)</u>
	97,100

- b) Transaksionet e mëposhtme ndërlidhen me konton e shpenzimeve të energjisë elektrike për kompaninë Burimi, për vitin që përfundon më 30 qershor 2014:

	€
Saldo në fillim e parapagimeve	550
Paraja e gatshme e paguar	5,400
Saldo në fund e akrualeve për energjinë elektrike	650

Kërkohet: Cila është shuma që duhet përfshirë në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për shpenzimet e energjisë elektrike për vitin që përfundon më 30 qershor 2014? (5 pikë)

Saldo nw fillim e parapagimeve	550
Paraja e gatshme	5,400
Akrualet nw fund	<u>650</u>
	6,600

c) Total i listës së saldove nga listat individuale të furnitorëve të kompanisë Vali ishte €438,900 më 30 qershor 2016. Kjo shumë nuk përshtatej me llogarinë kontrolluese të Valit. Më poshtë janë gabimet të cilat ishin zbuluar:

- 1 Një hyrje kontra prej €980 ishte regjistruar në llogarinë kontrolluese të të pagueshmeve, por jo edhe në listën individuale.
- 2 Shuma totale e librit të kthimeve të blerjeve ishte e nënvlerësuar për €1,000.
- 3 Një faturë e blerjeve prej €4,344 ishte regjistruar në llogarinë e furnitorit si €4,434.

Kërkohet: Cila është shuma që kompania Vali duhet të raportojë në pasqyrën e pozicionit financiar për llogaritë e pagueshme më 30 qershor? (5 pikë)

Saldo e pakorrigjuar	438,900
Hyrja kontra	(980)
<u>Gabimi nw regjistrim</u>	<u>(90)</u>
Saldo e korrigjuar	437,830

d) Më 31 dhjetor 2014 struktura e ekuitetit të një kompanie ishte si në vijim:

	€
Kapitali aksionar i zakonshëm (500,000 aksione nga 25c secila)	125,000
Llogaria e premisë së aksioneve	100,000

Gjatë vitit që përfundon më 31 dhjetor 2015 kompania kishte bërë një emetim të të drejtave për 1 aksion për çdo 2 që janë në dorë me 1 € për aksion dhe kjo e drejtë ishte shfrytëzuar në tërësi. Më vonë gjatë vitit kompania kishte bërë një emetim bonus për 1 aksion për çdo 5 që janë në dorë, duke e përdorur konton e premisë për këtë qëllim.

Kërkohet: Cila ishte struktura e ekuitetit/kapitalit të kompanisë më 31 dhjetor 2015?

(5 pikë)

(20 pikë)

d)

Regjistrimet në
ditar janë :

€

D	Paraja	250,000
---	--------	---------

(500,000 aksione x 1/2 x 1€)=250,000

Kr	Kapitali aksionar	62,500
----	-------------------	--------

(500,000 aksione x 1/2 x 25c)= 62,500

Kr	Premia	187,500
----	--------	---------

Pasqyra e Pozitës financiar e pas emitimit tw tw drejtave

€

Kapitali aksionar

187,500(750,000 aks. x 0.25c)

Premia

287,500

475,000

Regjistrimet në
ditar janë

€

Debi	Premia	37,500
------	--------	--------

(750,000 aksione x 1/5 x 25c)=37,500

Kredi	Kapitali aksionar	37,500
-------	-------------------	--------

Pasqyra e Pozitës Financiare e korrigjuar pa emitimit bonus

€

Kapitali aksionar

225,000(900,000aks x 25c)

Premia

250,000

475,000

Problemi 2

Bilanci i gjendjes i kompanisë “X” për vitin që përfundon më 30 Qershor 2015 dhe 2016 janë është si në vijim:

Bilanci i gjendjes				
	Ref.	30 Qershor 2016	30 Qershor 2015	
		€000	€000	€000
Pasuritë jo-qarkulluese (vlera neto në libra)	1	148,000		130,000
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet		14,000	9,100	
Të arkëtueshmet		21,400	12,500	
Paraja e gatshme		-	4,600	
		35,400		26,200
Totali i pasurive		<u>183,400</u>		<u>156,200</u>
Aksionet e zakonshme		110,000		109,000
Llogaria e premisë së aksioneve		5,000		4,000
Rezerva e rivlerësimit		14,000		2,000
Fitimi i mbajtur	1	28,000		18,000
Totali i kapitalit aksionar		<u>157,000</u>		<u>133,000</u>
Detyrimet afatgjata (huazime me kamatë prej 8%)		10,000		8,000
Detyrimet afatshkurtra				
Të pagueshmet		7,100	9,200	
Tatimet e pagueshme		8,000	6,000	
Mbitërheqja bankare (overdrafti)		1,300	-	
		<u>16,400</u>		<u>15,200</u>
Totali i kapitalit aksionar dhe detyrimeve		<u>183,400</u>		<u>156,200</u>

Shënime:

- (1) Shpenzimi vjetor i zhvlerësimit ishte €13,000,000.
- (2) Është paguar shuma prej €6,200,000 në emër të detyrimit ndaj tatimit i cili ekzistonte më 30 Qershor 2015.
- (3) Është marrë huazim shtesë më 1 Janar 2016. I tërë interesi i pagueshëm është paguar më 31 Dhjetor 2015 dhe 30 Qershor 2016.
- (4) Totali i dividendës së paguar gjatë vitit ishte €4,000,000.

Shënim shtesë: Zërat e pasqyrës së të ardhurave të cilat janë relevante për përgatitjen e Pasqyrës së rrjedhave të arkës, duhet ju t'i kalkuloni nga të dhënat e sipërsëhënuara.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme me metodën indirekte për vitin që përfundon më 30 Qershor 2016 duke u bazuar në formatin e kërkuar sipas SNK 7 (IAS 7) Pasqyrat e Rrjedhjes së Parasë së Gatshme. (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Kompania "X"

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 30 Qershor 2006

€

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative

Fitimi neto (L1)	14,000	
Shpenzimet e tatimit(L12)	<u>8,200</u>	
Fitim para tatimit	22,200	
Korrigjimet për:		
Zhvlerësimin	13,000	
Shpenzimet e interesit	<u>720</u> $(8000 \times 8\% / 2 + 10,000 \times 8\% / 2)$	
	35,920	
Rritja në stoqe	(4,900)	
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	(8,900)	
Zvogëlimi në llogaritë e pagueshme	<u>(2,100)</u>	
Paraja e gjeneruar nga operacionet	20,020	
Interesi i paguar	(720)	
Tatimi në fitim i paguar (L2)	(6,200)	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		13,100

Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive

Blerja e patundshmërive, impianteve dhe pajimeve (L3)	<u>(19,000)</u>	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet investive		(19,000)

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese

Arkëtimet nga emetimi i aksioneve	2,000	
Arkëtimet nga huazimi	2,000	
Pagesa e dividendës	<u>(4,000)</u>	
Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		-

Neto zvogëlimi i parasë së gatshme	(5,900)
Paraja e gatshme më 1 Korrik 2005	4,600
Paraja e gatshme më 30 Qershor 2006	<u>(1,300)</u>

Kalkulimet:

L1)	Fitimi i mbajtur		
Dividenda	€ 4,000	Saldo hapëse	€ 18,000
Saldo mbyllëse	<u>28,000</u>	Fitimi i vitit (Shifwr balancuese)	<u>14,000</u>

L2)	Tatimi në fitim		
Paraja e gatshme	€ 6,200	Saldo hapëse	€ 6,000
Saldo nw fund	<u>8,000</u>	Shpenzimet e tatimit	<u>8,200</u>
	14,200		14,200

L3)	Pasuritë jo-qarkulluese		
Saldo hapëse	€ 130,000	Zhvlerësimi	€ 13,000
Rezerva e rivlerësimit	12,000	Saldo mbyllëse	<u>148,000</u>
Blerjet	<u>19,000</u>		161,200
	161,000		

Problemi 3

(a) Llogarimbajtësi i Mart sh.p.k ka mbledhur informacionet e mëposhtme me qëllim të përpilimit të pasqyrave financiare për fund muajin deri më 31 korrik 2015:

Llogaria e parasë së gatshme në librin e madh, para çdo korigjimi, ka vlerë prej €2,300, megjithëse saldo në ekstraktin bankar më 31 korrik 2015 tregon vlerën prej €3,050. Rishikimi i regjistrimeve në kontabilitet si edhe nga ana e bankës, na tregon si më poshtë:

- Çeqet e papaguara më 31 korrik 2015 prej €1,652.
- Depozita e bërë më 31 korrik 2015 me shumë prej €1,300 ende nuk është regjistruar nga banka.
- Një rishikim i çeqeve të kthyera me ekstraktin bankar, tregon se banka ka debituar gabimisht llogarinë e kompanisë me €420 për kompaninë Marm sh.p.k.
- Kompania ka blerë dhe ka paguar për një kompjuter të ri me 25 korrik 2015. Çeku ishte në shumë prej €3,400 por është regjistruar gabimisht në librat e kompanisë me shumë prej €4,300.
- Shpenzimet e bankës ishin €82.

Kërkohet:

Përgatitni harmonizimin bankar për Mart.shpk. duke treguar saldon përfundimtare të bankës dhe të arkës

(8 pikë)

2(b) Kompania ka sistemin imprest (fiks) të arkës së parave të vogla prej €400. Pasi që është rimbushur, arka e parave të vogla kishte edhe €120 në para të gatshme dhe fatura prej €250, nga të cilat €100 ishin për shpenzimet e postës dhe €150 për zarfa. Kuponët për shumën e mbetur kishin të bëjë me kuponët për parkingun e automjeteve.

Kërkohet:

Përgatitni hyrjet në ditar që kanë të bëjë me arkën e parave të vogla.

(2 pikë)

(Totali = 10 pikë)

Zgjidhja(3)

1.MART CO.

Harmonizimi Bankar

31 korrik 2015

Saldo në bankë \$ 3,050	Saldo në librin e parasë së gatshme \$ 2,300
Plus:	Plus:
Depozita në tranzit 1,300	Gabimi në regjistrimin e kompjuterit
Gabimi I bankës — çeku i Marm 420 blerje	(4,300 - 3,400) 900
Minus:	Minus:
Çeçet e papaguara (1,652)	Shpenzimet bankare (82)
Totali \$ 3,118 (4 pikë)	Totali \$ 3,118 (4 pikë)

2 . Arka e parave të vogla400

Paraja e gatshme 400

Shpenzimet e postës 100

Shpenzimet e zarfave150

Shpenzimet tjera30

Arka e parave të vogla280 (2 pikë)

Problemi 4

Joni Sh.P.K. është e përfshirë në shpërndarjen e materialit të përbërë nga guri për industrinë ndërtimore. Bilanci Vërtetues në vijim është nxjerrë nga librat e llogarive më 31 dhjetor 2015:

	Debi	Kredi
	€	€
Zhvlerësimi i akumuluar – Ndërtesat më 01.01.2015		34,750
Zhvlerësimi i akumuluar – Pajisjet e zyrës më 01.01.2015		26,840
Zhvlerësimi i akumuluar – Kamionët më 01.01.2015		350,000
Shpenzimet administrative	103,510	
Lejimet për llogaritë e arkëtueshme tregtare		10,574
Banka	267,410	
Ndërtesat me kosto më 01.01.2015	241,020	
Tatimi i pagueshëm		16,500
Shpenzimet e shpërndarjes	754,210	
Shpenzimet e tatimit	13,640	
Stoqet më 01.01.2015	zero	
Kapitali aksionar – 100,000 aksione me 1.5€ secila		150,000
Toka	240,000	
Pajisjet e zyrës me kosto më 01.01.2015	42,400	
Blerjet	1,236,570	
Kthimet e blerjeve		10,869
Fitimet e mbajtura më 01.01.2015		593,119
Kthimet e shitjeve	14,570	
Të hyrat		2,478,560
Rezerva e rivlerësimit		64,851
Premia		30,000
Llogaritë e pagueshme		324,867
Llogaritë e arkëtueshme	487,600	
Kamionët me kosto më 01.01.2015	690,000	
	<u>4,090,930</u>	<u>4,090,930</u>

Informatat e mëposhtme janë në dispozicion si rezultat i hetimeve tuaja:

- (i) Nuk ka stoqe në fund.
- (ii) Zhvlerësimi duhet të ngarkohet si në vijim:

Toka	nuk zhvlerësohet
Ndërtesat	shih pikën nën (v) më poshtë
Pajisjet e zyrës	20% me metodën e saldosh zbritëse
Kamionët	25% me metodën drejtvizore

Zhvlerësimi llogaritet çdo muaj nga data e blerjes deri në datën e shitjes. (Proporcionalisht në vitin e blerjes dhe shitjes)
- (iii) Kamioni ishte përfshirë në një aksident më 01 maj 2015 dhe duhet të largohet si hedhurinë. 15,000€ janë pranuar për largimin e kamionit si hedhurinë. Kjo shumë është depozituar në llogarinë bankare. Kosto fillestare e kamionit ka qenë 75,000€ më 01 shtator 2013 dhe zhvlerësimi i akumuluar në datën e shitjes prej 31,250€. Joni Sh.P.K. e zëvendësoi këtë kamion duke blerë një kamion tjetër të ri në vlerë prej 80,000€ më 01 korrik 2015.
- (iv) Kamioni i ri i blerë siç është shpjeguar në pikën (iv) më lartë është paguar pjesërisht me çek dhe pjesa tjetër nga marrja e një kredie afatgjatë në vlerë prej 60,000€ me interes prej 6% në vit e cila nuk është paguar në fund të vitit. Interesi i kredisë duhet të përfshihet në shpenzimet financiare (të interesit).
- (v) Ndërtesa është rivlerësuar më 01 janar 2015 nga një vlerësues profesionist i cili ka vlerësuar ndërtesën në 200,000€. Vlerësuesi vendosi një jetë të dobishme ekonomike prej njëzet vitesh nga 01 janar 2015 dhe vlera e mbetur e ndërtesës në kohën njëzet vjeçare do të ishte 50,000€. Zhvlerësohet me metodën drejtvizore.
- (vi) Një klient i Joni Sh.P.K. ka paditur kompaninë, duke pretenduar se materiali i gabuar (i pasaktë) i është dorëzuar. Avokati i kompanisë Joni Sh.P.K. e ka këshilluar se ka më shumë gjasa që kompania të shpallet fajtores. Kjo do të rezultojë në faktin që Joni Sh.P.K. do të kërkohet të paguajë tarifa të gjykatës dhe ligjore në vlerë prej 15,000€. Gjykatësi në këtë rast do të vendosë lidhur me vlerën e dëmit. Ekziston një probabilitet prej 80% se dëmet do të jenë 100,000€ dhe një probabilitet prej 20% se dëmet do të jenë 60,000€.
- (vii) Shpenzimet e tatimit për vitin 2015 të përfshira në Bilancin Vërtetues janë të pasakta dhe duhet të jenë 18,900€. Kjo shumë është paguar në mars të vitit 2016.
- (viii) Një kthim i blerjeve në vlerë prej 6,000€ ende nuk është kontabilizuar.
- (ix) Joni Sh.P.K. ka shlyer borxhet të këqija në vlerë prej 7,200€. Lejimet për borxhet e dyshimta duhet të jenë 4% të të arkëtueshmeve.
- (x) Joni Sh.P.K. në fund të vitit ka pasur shpenzime aktuale shtesë ndaj shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të shpërndarjes në vlerë prej 2,860€ dhe 14,520€ respektivisht.

Kërkohet:

Përgatitni në një formë të përshtatshme për publikim, Pasqyrën e të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse dhe Pasqyrën e Pozitës Financiare për kompaninë Joni Sh.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015.

Shënim: Të gjitha llogaritjet (kalkulimet) duhet të paraqiten.

[30 pikë]

Zgjidhja e problemit 4

$$LL1) KMSH=0+1,236,570-10,869-6,000=1,219,701$$

LL2) Zhvlerësimi:

Ndërtesat:

$$\frac{200,000-50,000}{20} = 7,500$$

20 vite

Pajisjet e zyrës:

$$20\% \times (42,400-26,840)=3,112$$

Kamionët:

$$(690,000-75,000) \times 0.25 + 75,000 \times 0.25 \times 4/12 + 80,000 \times 0.25 \times 6/12 = 153,750 + 6,250 + 10,000 = 170,000$$

$$\text{Shpenzimet e zhvlerësimit} = 7,500 + 3,112 + 170,000 = 180,612$$

$$\text{Pajisjet (VNL)} = 42,400 - (26,840 + 3,112) = 12,448$$

$$\text{Kamionët (VNL)} = 695,000 - 488,750 = 206,250$$

Kamionët-Kosto		Zhvlerësimi i akumuluar-Kamionët	
S`690,000	75,000 Shitja	Shitja 31,250	s`350,000
80,000 Blerja			Shpenzimet 170,000
S`695,000			s`488,750

$$\begin{array}{l} LL3) D: \text{Paraja e gatshme} \quad 15,000 \\ D: \text{Zhvlerësimi i akumuluar} \quad 31,250 \\ D: \text{Humbja nga shitja} \quad 28,750 \\ \quad K: \text{Kamioni-Kosto} \quad 75,000 \end{array}$$

$$\begin{array}{l} LL4) D: \text{Kamioni-Kosto} \quad 80,000 \\ \quad K: \text{Paraja e gatshme} \quad 20,000 \\ \quad K: \text{Kredia Afatgjatë} \quad 60,000 \end{array}$$

$$\text{Shpenzimet e interesit} = 60,000 \times 6\% \times 6/12 = 1,800$$

$$LL 5) \text{ Vlera e rivlerësuar} \quad 200,000$$

$$\text{VNL e ndërtesave në datën e rivlerësimit} = 241,020 - 34,750 = \underline{206,270}$$

$$\text{Rënie në rezervën e rivlerësimit} \quad 6,270$$

$$\begin{array}{l} LL 6) D: \text{Shpenzimet e provizionit} \quad 115,000 \\ \quad K: \text{Provizioni} \quad 115,000 \end{array}$$

$$\begin{array}{l} LL 7) D: \text{Shpenzimet e tatimit} \quad 5,260 (18,900 - 13,640) \\ \quad K: \text{Tatimi i pagueshëm} \quad 5,260 \end{array}$$

$$LL8) D: LL/P \quad 6,000$$

K: Kthimet e blerjeve

6,000

LL9) Lejimet=(487,600-7,200) x 4%=19,216

Shpenzimet e borxheve të dyshimta=19,216-10,574=8,642

LL/ A neto=487,600-19,216=468,384

PASQYRA E TE HYRAVE DHE SHPENZIMEVE

Shitjet	2,478,560
Kthimet e shitjeve	(14,570)
KMSH	(1,219,701)
<i>Fitimi bruto</i>	<i>1,244,289</i>
Shpenzimet e shpërndarjes(754,210+14,520)	(768,730)
Shpenzimet administrative(103,510+2,860)	(106,370)
Shpenzimet e zhvlerësimit(LL2)	(180,612)
Shpenzimet e provizioneve (LL6)	(115,000)
Shpenzimet e borxheve të këqija	(7,200)
Shpenzimet e borxheve të dyshimta(LL9)	(8,642)
Humbja nga shitja(LL3)	(28,750)
Shpenzimet e interesit(LL4)	(1,800)
Shpenzimet e tatimit	(18,900)
<i>Fitimi neto</i>	<i>8,285</i>

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PASURITE JO-QARKULLUESE

€

Toka	240,000
Ndërtesat(200,000-7,500)	192,500
Pajisjet e zyrës(LL/2)	12,448
Kamionët (LL/2)	206,250
Totali I pasurive jo-qarkulluese	651,198

PASURITE QARKULLUESE

Stoqet	--
LL/ A(LL9)	468,384
Paraja e gatshme(267,410-20,000+15,000)	262,410
Totali i pasurive qarkulluese	730,794

TOTAL PASURITE **1,374,792**

EKUITETI

Kapitali aksionar	150,000
Premia e aksioneve	30,000
Fitimi i mbajtur(593,119+8,285)	601,404
Rezerva e rivlerësimit(64,851-6,270)	58,581
Totali i ekuitetit	839,985

DETYRIMET

Detyrimet afatgjata

Kredia	60,000
Detyrimet afatshkurta	
Tatimi i pagueshëm (16,500+5,260)	21,760
Provizionet	115,000
Llogaritë e pagueshme(324,867-6,000)	318,867
Akrualët (2,860+14,520)	17,380
Interesi i pagueshëm	1,800

Totali I detyrimeve afatshkurta 474,807

TOTALI I EKUITETIT DHE DETYRIMEVE **1,374,792**

Problemi 5

(A) Edi Sh.P.K. është e përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës në Kosovë. Analisti financiar ka kërkuar nga ju, kontabilist i ri i certifikuar, për ndihmë në kontabilizimin e saktë të Pronës, Fabrikës dhe Pajisjeve (PFP) në kuadër të kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015.

Shpenzimet e mëposhtme kanë ndodhur në hapësirën e mullinjve të erës:

	€
Rregullimi (përgatitja) e hapësirës	80,000
Mirëmbajtja vjetore sapo të bëhet operacionale	30,000
Trajnimi i stafit në përdorimin e saktë të mullinjve të erës sapo kur të hyjnë në funksion	25,000
Detyrimet e importit të mallrave të blera	28,000
Ekzaminimi fillestar i hapësirës	40,000
Paga e menaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar mullinjtë e erës	140,000
Pagat e punëtorëve të përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës	300,000
Pagat vjetore të punëtorëve në kohën kur mullinjtë e erës do të hyjnë në funksion	100,000
Kostot e testimit	60,000
Materialet e blera për mullinjtë e erës neto (pa TVSh)	250,000

Kërkohet:

- a) Kalkuloni shumën që duhet të kapitalizohet si Prona, Fabrika dhe Pajisjet (PFP) për mullinjtë e erës si më lartë. **(15 pikë)**

(B) Zyra qendrore e Edi Sh.P.K. është e vetmja ndërtesë e kompanisë. Vlerësuesi profesional ka rivlerësuar këtë ndërtesë më 01 janar 2015 në 2,100,000€. Edi Sh.P.K. ka miratuar një politikë të rivlerësimit të ndërtesave nga kjo datë e rivlerësimit dhe ka vendosur që jeta origjinale e dobishme e ndërtesave nuk ka ndryshuar si rezultat i rivlerësimit. Ndërtesa është blerë më 01 janar 2005. Kosto e ndërtesës në blerje ka qenë 2,500,000€ dhe zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2014 kapi vlerën 500,000€. Zhvlerësimi është llogaritur në mënyrë të njëtrajtshme (me metodën drejtvizore) për jetën e përdorimit prej 50 viteve. Vlerësuesi profesional beson se vlera e mbetur e ndërtesës do të jetë 600,000€ në fund të jetës së dobishme të saj.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 16 – Prona, Fabrika dhe Pajisjet:

- (i) Kalkuloni shpenzimet e zhvlerësimit të ndërtesës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2015 bazuar në informatat e dhëna në skenarin e mësipërm (B). **(5 pikë)**

[20 pikë]

Zgjidhja e problemit 5

(A) Kalkulimi i shumës që duhet të kapitalizohet:

	Vlerat e dhëna në €		Vlerat që plotësojnë kushtet për kapitalizim në €
Rregullimi (përgatitja) e hapësirës	80,000	PO	80,000
Mirëmbajtja vjetore sapo të bëhet operacionale	30,000	JO	
Trajnimi i stafit në përdorimin e saktë të mullinjve të erës sapo të hyjnë në funksion	25,000	JO	
Detyrimet e importit të mallrave të blera	28,000	PO	28,000
Ekzaminimi fillestar i hapësirës	40,000	PO	40,000
Paga e menaxherit të projektit për të ndërtuar dhe menaxhuar mullinjtë e erës	140,000	PO	140,000
Pagat e punëtorëve të përfshirë në ndërtimin e mullinjve të erës	300,000	PO	300,000
Pagat vjetore të punëtorëve në kohën kur mullinjtë e erës do të hyjnë në funksion	100,000	JO	
Kostot e testimit	60,000	PO	60,000
Materialet e blera për mullinjtë e erës neto (pa TVSh)	250,000	PO	250,000
			898,000

* Vlera totale që do të kapitalizohet si pasuri jo-qarkulluese është 898,000€

(B) Kalkulimi i shumës që duhet të kapitalizohet:

Ndërtesa ('000€)

		€			€
01.01.05	Kosto e blerjes	2,500	01.01.15	Rezerva e rivlerësimit	400
01.01.15		2,100			

Zhvlerësimi i akumuluar ('000€)

		€			€
01.01.15	Rezerva e rivlerësimit	500	01.01.15	Saldo në fillim	500
			31.12.15	Shp. zhvlerësimit	37.5
			31.12.15		37.5

Rezerva e rivlerësimit ('000€)

		€			€
			01.01.15	Rivlerësimi i Nd.	100
					100

Kalkulimi i zhvlerësimit:

$2,100,000 - 600,000 / 40 \text{ vite} = 37,500$ Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2015